



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 525 / Prot. 117

Durrës, më 28.3.2022

VENDIM

Nr. 32, datë 28.3.2022

PËR

"RIORGANIZIMIN NËN 20% TË PROGRAMIT TË STUDIMIT "BANKË - FINANCË", NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE, PRANË DEPARTAMENTIT TË FINANCË KONTABILITETIT, NË FAKULTETIN E BIZNESIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës."

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" në Udhëzimin Nr.01, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Për miratimin e riorganizimit nën 20% të programit të studimit "Bankë - Financë", në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave, pranë Departamentit të Financë Kontabilitetit, në Fakultetin e Biznesit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Zv. Rektorët
 - ✓ Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Fakultetit të Biznesit
 - ✓ Drejtuesi i Njesisë Bazë pranë Departamentit të Financë Kontabilitetit
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2022-2023.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

